



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-4004/26
Kaçanik, 26.02.2026

Në bazë nenit 12.2 (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 4.3 të Statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës Nr. 237/15 të datës 16.06.2015, të Kërkesës së Asociacionit të Komunave të Kosovës prej datës 12.02.2026, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 26 shkurt 2026, mori këtë:

VENDIM

PËR DELEGIMIN E DY ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK, NË KUVENDIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

- Me këtë Vendim, delegohen dy (2) anëtarë nga Kuvendi i Komunës Kaçanik, përfaqësues në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës:
 - 1.1. Elona Gjini anëtare e KK nga subjekti politik i PDK; dhe
 - 1.2. Kadrije Lika Troni anëtare e KK nga subjekti politik i LVV.
- Delegimi i dy (2) anëtarëve nga pika 1. e këtij vendimi, bëhet sipas Kërkesës së AKK, në bazë kritereve të përcaktuara në Statutin e AKK.
- Detyrat e anëtarëve të deleguar në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës janë të përcaktuara në Statutin e AKK.
- Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është, Kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës e datës 12.02 2026.
- Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Anëtarët e deleguar të KK, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Kryetari i Komunës, Drejtorja e Buxhetit dhe Financave dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Seladin Troni

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLICA E KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAÇANIK			
Data	12.02.26	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë	
01	60/01-4004	.1.	

Sabedin Vishi

From: Safete Beqiri <safetebeqiri@komunat-ks.net>
Sent: Wednesday, February 11, 2026 2:30 PM
To: Sabedin Vishi
Subject: Propozim - Formula për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvend të AKK-së
Attachments: Formula e zgjedhjes se delegatit per Kuvend te AKK-se.pdf

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

I nderuar Kryetar,

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ju fton që, në përputhje me Statutin dhe rregullat e brendshme të AKK-së, të emëroni delegatët e Komunës Suaj për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të AKK-së. Bashkangjitur gjeni **Propozim-Formulën** për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvendin e AKK-së. Në bazë të kësaj Propozim-Formule, si dhe duke u mbështetur në rezultatet e zgjedhjeve të fundit për Kuvendin Komunal, propozohet që Komuna Juaj të përfaqësohet nga:

- PDK – një anëtar i Kuvendit Komunal
- LVV – një anëtar i Kuvendit Komunal

Ju njoftojmë se kjo është vetëm **formulë orientuese/propozuese** e AKK-së. Megjithatë, dëshirojmë të theksojmë se vendimin final për përfaqësim e marrin Kuvendet Komunale përkatëse, dhe se delegimi i përfaqësuesve duhet të miratohet me vendim formal nga Kuvendi Komunal, në përputhje me procedurat ligjore dhe statutore.

Ju lutemi që pas miratimit në Kuvendin Komunal, vendimin zyrtar me emrat e delegatëve të përzgjedhur ta dërgoni në adresën elektronike: safetebeqiri@komunat-ks.net
Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ju dëshirojmë suksese dhe punë të mbarë!

Me respekt,

Safete Beqiri
Asistente e Administratës
Asociacioni I Komunave të Kosovës
Tel: +381 38 / 245-734
Fax: +381 38/245-733
www.komunat-ks.net
safetebeqiri@komunat-ks.net



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Për:	Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin/en e Kuvendit të Komunës
Nga:	Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv, Asociacioni i Komunave të Kosovës
Data:	10 Shkurt 2026
Subjekti:	Formula për zgjedhjen e delegatëve të Komunës për Kuvend të AKK-së

I nderuar Kryetar,

I/E nderuar Kryesues/e i/e Kuvendit të Komunës,

Sipas Statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, numri i delegatëve për Kuvend të AKK-së është caktuar në bazë të kriterëve të shënuara në vijim:

Përveç Kryetarit të Komunës, komunat i delegojnë për çdo 10 anëtar të KK-së, 1 (një) përfaqësues në Kuvendin e AKK-së. Kërkohet edhe përfaqësimi i partive politike dhe përfaqësimi gjinor.

Në Kuvend marrin pjesë edhe përfaqësuesit e minoriteteve në pajtim të një marrëveshjeje të Kryetarëve të Komunave (numri dhe përkatësia në bazë të përfaqësimit të tyre në KK).

Komunat do t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Komunës, në proporcion me numrin e votave që partia i ka fituar në Kuvendin Komunal.

Kjo formulë e përfaqësimit është aplikuar që nga fillimi.

Me respekt,

Sazan Ibrahimimi

Drejtor Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës